



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLICOF KOSOVA
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm /Office of The Auditor General /Kancelarija Generalnog Revizora

Nr. i dokum:21.1.1-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË
ZYRES SË KRYEMINISTRIT PËR VITIN E FËRFUNDUAR MË
31 DHJETOR 2008**

Prishtinë, 27 Korrik 2009

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II Hyrje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e ZKM-së dhe Vlersimet e ZAP-it

Lista e shkurtesave dhe fjalëve

AP	Auditori i Përgjithshëm
ABGJ	Agjensioni i Barazisë Gjinore
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
IA	Instruksioni Administrativ
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
FPP	Fjalori i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MFK	Menaxhimi Financave dhe Kontrolli
ONISA (INTOSAI)	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
P/F	Pasqyra Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SNISA (ISSAI)	Standardi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UA	Udhëzimi Administrativ
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka audituar Pasqyrat Financiare të ZKM-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi ynë është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat të cilat ne i kemi vlerësuar si të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në shqyrtimin e prezantimit dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2008 dhe kryerjen e testimeve thelbësore për të konfirmuar saktësinë dhe vlefshmërinë e transaksioneve financiare.

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtet, në të gjitha aspektet materiale*. Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen në faktin se pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare. (ISSAI 400 Opinion i pa kualifikuar me theksim të çështjes)

Auditimi i Pasqyrave Financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka shpalosur disa dobësi që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit dhe sistemin e kontrollit të brendshëm:

- Shkalla e ultë e ekzekutimit të buxhetit përfundimtar me 60.31%;
- Mos barazimi ndërmjet evidencave kontabël të ZKM-së dhe SIMFK për sa i përket avanseve dhe kodit ekonomik;
- Mos shpalosja (komentet) e mjaftueshme e kërkuar me udhëzimin Administrativ 2008/13 për përpilimin e raporteve financiare të organizatave buxhetore;
- Aktivitetet e prokurimit janë ndërmarr dhe janë zbatuar jo gjithëherë në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe;
- Dobësi në menaxhimin e shpenzimeve veçanërisht për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, shpenzimeve të telefonisë dhe parës së imtë.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se janë ndërmarr masa përmirësimi në aktivitetin e sistemit të kontrollin brendshëm në ZKM. Përkundër kësaj, Kontrolli i brendshëm financiar reflekton akoma dobësi.

Rekomandimi ynë kryesor është që Sekretari Permanent t'i adresoj dobësitë e lartë përmendura në mënyrë që të përmirësoj efikasitetin e menaxhmentit dhe kontrollit të brendshëm financave publike të ZKM-së.

II. HYRJE

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Zyrës së Kryeministrit të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

III. Giendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2007 kishte dhënë 8 rekomandime. Nga këto, 3 janë implementuar pjesërisht ndërsa të tjerat mbeten ende të pa implementuara. Ato më të rëndësishmet që nuk janë implementuar janë:

- a. ZKM rekomandohet të zbatoj në tërësi Rregullen Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02, në lidhje me nevojat e saj dhe për përdorimin e parasë së imtë.
- b. Menaxhmenti duhet të sigurohet që regjistri i pasurisë është i përditësuar dhe rregullisht i mirëmbajtur. I gjithë stafi duhet të udhëzohet që të kthejnë të gjitha pajisjet me të cilat janë ngarkuar, atëherë kur ata lëshojnë organizatën.
- c. Në rekomandojmë që menaxhmenti të vendos kontrole për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, që të mos lejoj shpenzime pa u plotësuar të gjitha kërkesat sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative përkatëse.

Kjo do të thotë se dobësitë e vërejtura dhe të raportuara më herët ende ekzistojnë. Konkluzionet dhe Rekomandimet tona në lidhje me këtë ishin se Menaxhmenti duhet të ndërmarrë veprime të shpejta dhe të qëndrueshme mbi rekomandimet dhe të gjeturat e auditimit.

IV. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Auditimi i ZKM-së ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të ZKM-së, japin një pasqyrë të vërtet dhe të drejtë dhe nëse regjistrat kontabel, sistemet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. QASJA E AUDITIMIT

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 5 Mars 2009 deri më 25 Prill 2009, ne bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të ZKM-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të ZKM-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".
3. Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në ZKM, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të ZKM-së, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtet, në të gjitha aspektet materiale*. . Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen në faktin se pasuritë fikse nuk janë shpalosur në pasqyra financiare. (ISSAI 400 *Opinion i pa kualifikuar me theksim të çështjes*).

VII. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KRYESORE TË AUDITIMIT

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon se Zyra e Kryeministrit nuk ka tejkaluar zërat e buxhetit të rivlerësuar sipas kategorive ekonomike, si dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2008. Buxheti vjetor i ZKM ishte 6,803,405 €. Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2008 ishte 4,103,138 € apo 2,700,267 € më pak se buxheti vjetorë. Buxheti i shpenzuar është në nivelin prej 60,31%.

Konkluzioni

ZKM ka nevojë të përpiloj kërkesat buxhetore që do të ishin në përputhje me nevojat reale të shpenzimeve për mbulimin e aktiviteteve operative të ZKM. Mos përputhja e buxhetit me nevojat reale ka rezultuar me një mbetje të konsiderueshme të buxhetit të pa shfrytëzuar në fund të vitit. Kjo ka pasur ndikime në tërësinë e BKK, për shkak se këto mjete kanë mund të orientohen në sektorë tjerë dhe mos të shfaqen suficite të konsiderueshme buxhetore..

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

Kryerjen e analizave më të thella dhe një planifikim më të mire të nevojave buxhetore për vitet e ardhshme. Kjo do të përmirësoj shkaqet e mbetjeve buxhetore në fund të vitit dhe do të përmirësoj në përgjithësi performancën e shfrytëzimit të BKK-se në tërësi.

2 Pasqyrat Financiare

Këto pasqyra financiare janë përgjegjësi e Menaxhmentit të ZKM-së. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të këtyre pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.

Pasqyrat Financiare të vitit 2008 janë korrigjuar me 14.04.2009 edhe pas korrigjimeve P/F nuk kanë qenë complete. Ato përmbajnë informacione korrekte në shënime sqaruese, sidomos në tabelën nr. 7, 8 dhe 9.

Konkluzioni

Mungesa e shpalosjeve dhe komenteve ne P/F është mangësi dhe nuk korrespondon me kërkesat e bazuara në Udhëzimin Administrativ 2008/13 të MEF-it. Mungesat e shënimeve sqaruese shkaktajnë kufizim të informatave te pasqyrave financiare.

Rekomandimi nr. 2

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Përgatitje të P/F sipas kërkesave;
- Harmonizimin ne baza mujore të shpenzimeve dhe të hyrave te ZKM-se me regjistrimet ne SIMFK.

3. Realizimi i Buxhetit

3.1 Të Hyrat

Të hyrat vetjake në Zyrën e Kryeministrit për vitin 2008 kanë qene 182,779 €. Të hyrat e mbledhura kryesisht ishin realizuar nga shitja e Gazetave zyrtare, donacionet dhe qiraja. Këto të hyra janë të regjistruara në SIMFK.

Sipas një kontrate të lidhur më 19.04.2006 ndërmjet UNMIK-ut, KFOR-it, Qeverisë dhe INA sh.a Zagreb, obligimet e pa inkasuara nga INA deri në dhjetor 2008, për 31 muaj ishin 682,000 €. Gjatë vitit 2008 ishin inkasuar vetëm 100,000 €. Shuma e mbetur e të hyrave nga qiraja e pa inkasuar është 582,000 €, të cilën ZKM-ja duhet inkasoj në periudhën e ardhshme.

Mungojnë procedurat e shkruara që sigurojnë se të hyrat vetjake janë nën kontrollë.

Konkluzioni

Mungesa e procedurave të shkruara dhe zbatimit të tyre janë arsye për paqartësi për bazën dhe plotësinë e të hyrave vetjake.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Planifikimin dhe regjistrimin e plotë të hyrave.
- ZKM te ndërmarr te gjitha masat qe shuma e përllogaritur e qirasë te inkasohet sipas kontratës.

3.2 Pagat dhe Mëditjet

Buxheti për kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2008 ka qene 1,078,325 €, ndërsa shpenzimet aktuale për paga ishin 929,051 €. Pagat dhe mëditjet në vitin 2008 ishin për 110,933 € më të mëdha se në vitin 2007 ose për 13,54%. Numri i te punësuarve ne ZKM në dhjetor të vitit 2008 ishte 289 ndërsa ne vitin 2007 kishte 256 te punësuar.

3.3 Mallrat dhe Shërbimet

Shpenzimet aktuale në vitin 2008 në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve ishte 2,771,236 €

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit

Me rastin e ekzaminimit te këtyre shpenzimeve kemi gjetur se tri pagesa (CPO Nr. 10480064, CPO nr. 12508101 dhe CPO nr. 12508102) janë bërë pa kompletimin e dokumentacionit të duhur:

- Mungon përshkrimi i qëllimit te udhëtimit jashtë vendit;
- Mungojnë faturat e hotelit, aeroplanit, kopja e pasaportës;
- Shumat e llogaritura për këso qëllime janë të pa qarta dhe me gabime

Konkluzioni

Mos implementimi i plotë i rekomandimeve nga viti 2007 ka rezultuar që dobësitë sa i përket shpenzimeve te udhëtimeve zyrtare të përsëriten. Veprimet e tilla janë ne kundërshtim me Rregullin financiar dhe Udhëzimet e Thesarit, nr. 02 – Shpenzimet e parave publike.

Rekomandimi nr. 4

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 mbi udhëtimet zyrtare si dhe mëditjet për këto udhëtime, për të siguruar një përdorim ekonomik dhe efikas të mjeteve buxhetore.

3.4 Prokurimi

Gjatë vitit 2008 ZKM kishte ndërmarrë 191 aktivitete prokurimi sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik të Kosovës Nr. 02/L-99, prej të cilave 16 ishin anuluar. Vlera totale e kontratave ishte 1,674,367 €, prej te cilave kontrata për furnizime 408,807 € dhe kontrata për shërbime 1,265,549 €.

Nga 175 aktivitete të prokurimit, 13 aktivitete ishin zhvilluar me procedurë të hapur, 14 me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, 46 me procedura te kuotimit të çmimeve dhe 102 me procedurë të vlerës minimale.

Shpenzimet e reprezentacionit

Zyra e Kryeministrit kishte paguar gjate vitit 2008 shumen prej 172,743 € ne emër të shpenzimeve të reprezentacionit.

Në gjashtë mostra në vlerë prej 6,779 € lidhur me shpenzimet e reprezentacionit, kontratat janë nënshkruar nga Shefi i kabinetit të Kryeministrit dhe pa zotim të mjeteve. Ky zyrtar nuk është i autorizuar për nënshkrimin e dokumenteve kontraktuese sipas LPP. Faturat nuk specifikojnë llojet e shërbimeve (ushqim, pije).

Konkluzioni

Kontratat janë nënshkruar nga personi jo i autorizuar. Kontratat publike të nënshkruara nga kushdo, përveç zyrtarit të Prokurimit të autoritetit kontraktues është në kundërshtim me ligjin. Ky fakt flet për dobësitë e kontrollit të brendshëm.

Rekomandim nr. 5

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Të vendosen kontrole adekuate për t'u siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik 02/L-99. Kontratat e prokurimit të nënshkruhen nga Departamenti i Prokurimit.

Regjistrimi i inventarit në evidencat e pasurisë

Tek tri kontrata në shumë prej 24,828 € artikujt e pranuar nuk janë regjistruar në regjistrin e depos. Kjo është vërejtur tek Furnizimi me tavolina për sallën P 38 , inventar dhe furnizim për zyre. Në këto rrethana krijohet mundësia që inventari apo malli i pranuar të mos regjistrohet në regjistrat e pasurisë dhe menaxhmenti i ZKM-së të mos ketë informacione të plota mbi pasurinë.

Konkluzioni

Pranimi i artikujve jashtë procedurave të rregullta të deposë lë të hapur mundësinë kjo pasuri fare të mos regjistrohet dhe paraqet rrezik potencial për manipulim dhe keqpërdorim.

Rekomandim nr. 6

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Të ndërmerren masa që të sigurohet se të gjitha pasuritë e blera regjistrohen dhe se informatat e marra lidhur me inventarin (pasurinë) janë të plota.

3.5 Investimet Kapitale

Buxheti për investime kapitale për vitin 2008 ishte 236,096 €, ndërsa shpenzimet aktuale ishin në vlerë prej 33,150 €. Mjetet e buxhetuara për investime kapitale ishin shpenzuar vetëm 14%.

3.6 Subvencionet dhe transferet

ZKM për Subvencione dhe Transfere kishte të buxhetuara 1,478,154 €, ndërsa shpenzimet aktuale ishin vetëm 253,278 €. Mjetet e pa shpenzuara nga kategoria e Subvencioneve dhe transfereve ishin 1,224,876 € apo 82,8% të totalit të kësaj kategorie. Kjo flet për një shkallë shumë të ulët të shfrytëzimit të buxhetit nga kjo kategori.

3.7 Menaxhimi i pasurive

Paragrafi 1 i nenit 15 të Instruksionit Administrativ Nr. 2005/11 mbi Menaxhimin dhe Regjistrimin e pasurive qeveritare përcakton që të gjitha pasuritë kapitale dhe jo kapitale do të llogariten dhe regjistrohen në regjistrin kontabël.

Kjo kornizë e rregullave ekziston për të siguruar që pasuritë publike të menaxhohen, të regjistrohen dhe të mbrohen në mënyrën e duhur për të minimizuar rreziqet e mashtrimit, shpërdorimit dhe keqpërdorimit.

ZKM-ja gjatë vitit 2008 nuk kishte mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë të pasurive.

Gjetjet tona të auditimit kanë identifikuar:

- Pasuritë e blera janë shpërndare tek zyrtarët pa u regjistruar në regjistrin kontabël; .
- Në vitin 2007 pasurit jo financiare janë raportuar në shumë prej 201,996 €, kurse Raporti Vjetor Financiar i BKK-se për 2008 ka raportuar pasuritë në shumë prej 125,719 €;
- ZKM-ja ka themeluar një Komision Regjistruar që ka bërë një inventarizim jo të plotë të pasurive;
- Zyrtari/ja e pasurisë nuk i posedon dosjet e plota të dokumenteve të nevojshme për pasuri;
- Zyrtari/ja e pasurive nuk kishte qasje në SIMFK për regjistrimin e pasurive në regjistër kontabël

Konkluzion

ZKM është duke e implementuar një sistem të menaxhimit të pasurive. Sistemi duhet të përvetësohet, të përsoset dhe të përfshijë të dhënat që janë të përshtatshme për menaxhim dhe shpalosje.

Rekomandimi nr. 7

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Që pasuritë e blera nga ZKM duhet të regjistrohen para se të njëjtat të shpërndahen tek

- zyrtarët e caktuar;
- Zbatojë kërkesat e IA 2005/11 për të përmirësuar procesin e menaxhimit të pasurive.

4. Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemet e Kontrolleve të Brendshme janë strukturë organizative, procedura operative, dhe praktika administrative të adoptuara nga të gjitha nivelet e Menaxhmentit për të ofruar siguri të arsyeshme që programet dhe aktivitetet administrative janë duke u zhvilluar në mënyrë efektive në pajtim me objektivat e parapara.

Kontrolli i Brendshëm është një proces i integruar që është i ndikuar nga Menaxhmenti i Entitetit dhe personeli, si dhe është i dizajnuar që të ofroj siguri të arsyeshme që në përputhje me misionin e entitetit, arrihen objektivat kryesore në vijim:

- Të realizoj operacione në mënyrë të përpiktë, etike, ekonomike, efikase dhe efektive;
- Ti përmbush obligimet që i ka në përgjegjësi;
- Ti zbatoj Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Të ruaj resurset nga humbjet e mundshme.

Krahas gjetjeve të përshkruara më lart, ne kemi vërejtë se zyrtari i pranimit/logjistikes ishte i sistemuar në kuadër të departamentit të prokurimit. Një gjendje e tillë është në kundërshtim me nenin 6 të UA 2005/11 Menaxhimi dhe regjistrimi i Pasurive Qeveritare.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

- Ndarjen e duhur të detyrave dhe përgjegjësive në kuadër të ZKM-së
- Një program funksional që përcakton qartas procedurat e kontrollit të brendshëm të cilat synojnë të përforcojnë kontrollin e brendshëm.

5. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur këshillëdhënëse e cila ofron siguri të arsyeshme, e dizajnuar që të përmirësojë dhe të shtojë dobinë e funksionimit të një organizate. I ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave duke ofruar qasje sistematike dhe të disiplinuar mbi vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve.

ZKM ka të themeluar NJAB me një auditor. Ne kemi vërejtur se në kuadër të ZKM-së është kryer një pilot auditimi si Pilot projekt i Agjensionit Evropian për Rindërtim me objektiv “Menaxhimi i Veturave Zyrtare”. Po ashtu, nga auditori i brendshëm janë mbuluar edhe këto fusha: Menaxhimi i procedurave të prokurimit, menaxhimi i pasurisë, menaxhimi i shpenzimeve telefonike dhe menaxhimi i shpenzimeve të karburanteve. Raportet e dorëzuara nga auditori i

brendshëm janë vlerësuar si produkte të mira, por është vërejtur se nga 39 rekomandime të dhëna, 15 prej tyre nuk janë zbatuar.

Konkluzioni

Ne konkludojmë se auditori i brendshëm ka përgatit planet e auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe ka fokusuar auditimet në fushat me rrezik më të lartë. Rezultatet e auditimit kanë kontribuar në përmirësimin e aktiviteteve operative.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Sekretarin Permanent të ZKM-së që të siguroj:

Auditimi i brendshëm është plotësisht funksional, të fuqizij rolin e tij si dhe maksimalisht të adresojnë rekomandimet e auditimit.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si ;nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të **mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka patur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II Komentet e ZKM-së dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj Komenteve

Nr.	Komentet e ZKM	Përgjigja e ZKM-së
1	<p>Rezultati financiar ne krahasim me buxhetin e aprovuar</p> <p>Buxheti i ZKM-se ka qene i planifikuar realisht dhe ne harmoni me kufijtë buxhetor për vitin 2008.</p> <p>Mirëpo, është i shpenzuar vetëm 60.31%, sepse kane ndodhur ndryshime strukturale ne Zyrën e Kryeministrit, dhe disa programe buxhetore nuk kane mundur te shpenzohen për shkak te rrethanave objektive.</p> <p>Buxheti për këto kategori buxhetore nuk janë thjeshte te natyrës se shpenzimeve operative si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxhetin e Zyrës se Komuniteteve ne kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, - Fondi për Media te Komuniteteve i cili fare nuk është shpërndarë, - Heqja dore nga blerja e automjeteve për vitin 2008, - Buxheti i pa shpenzuar i Komisionit te Demarkacionit, -Buxheti i Fondit për persona të pa gjetur etj. 	<p>Kemi analizuar komentet e dhëna , mirëpo sqarimet e elaboruara nuk janë argumente te mjaftueshme që ta ndryshojmë rekomandimin tonë.</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë.</p>

2	<p>Pasqyrat Financiare</p> <p>Paraqitja e pasqyrave Financiare është bere ne harmoni te plote me rregulloren mbi raportimin financiar 2008/13, edhe pse ka pasur dhe ka paqartësi ne këtë rregullore, sidomos te ndarjet buxhetore.</p> <p>Shpalosjet e paraqitura janë te lidhura edhe me tabelën nr. 5 faqe 11 dhe tabelën ne faqe 20, raporti sipas kodeve ekonomike dhe kodeve buxhetore, te dhëna te cilat nuk i paraqet ne mënyre te detajizuar udhëzimi administrative 2008/13, andaj edhe janë shtuar këto tabela.</p>	<p>Komentet e juaja lidhen me tabela tjera të veçanta që nuk i përgjigjen çështjes dhe si të tilla nuk ndikojnë që ta ndryshojmë rekomandimin tonë.</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë.</p>
3.1	<p>Të Hyrat</p> <p>Ekziston barazimi i te hyrave me SIMFK, shih tabelën nr. 20 dhe raportin e Thesarit. Mirëpo, te hyrat nga INA- Zagreb, deri ne përfundim te vitit nuk kane pasur te bëjnë me ZKM-ne. Kontrata e lidhur ne vitin 2006, ne mes te PSSP-se dhe INA-Zagreb, nuk ka pasur lidhje me ZKM-ne. Pas rekomandimeve te MEF-it, lidhur me problemin e sistemimit te këtyre te hyrave, është rekomanduar qe te evidentohen këto te hyra si te ZKM-se, edhe pse kjo kohe nuk ka korresponduar me datën e dorëzimit te raportit financiar.</p> <p>Këto te hyra janë vetëm evidente ne emër te ZKM-se kurse evidentohen dhe regjistrohen nga Thesari. Andaj, nuk ka pasur pasiguri ne këto te hyra dhe janë te evidentuara ne Thesar.</p>	<p>ZKM-ja është pjesëmarrëse e nënshkrimit të kontratës se trajtuar ne raport. ZKM-ja duhet te përcjell realizimin e kontratës dhe te hyrat qe rrjedhin nga ajo. Arsyet e komentuara nuk kanë ndikim në ndryshimin e rekomandimit tonë.</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë</p>
3.3	<p>Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit,</p> <p>Konstatimi është i sakte, kemi një rast ku Zyrtari ka udhëtuar jashtë vendit dhe ka qëndruar ne Amerike, por nuk ka sjell fature te hotelit, kurse ka marre shpenzimet vetëm te pjesës se ushqimit. Nëse hiqet dore për një pjese te shpenzimeve nga ana zyrtarit nuk konsiderojmë se është shkelje e procedurave..</p>	<p>ZKM pajtohet me të gjeturën për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë</p>

	<p>Pika 3.4 " Mbi numrin e Prokurimeve "</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i sakte i prokurimeve te kryera ne vitin 2008 nga ZP-ZKM është 191 te cilat janë te prezantuara pranë auditoreve dhe ne KRPP. Nga këto <table border="0"> <tr> <td>1. Te anuluarat për arsye objektive dhe ne mungese te ofertave</td> <td>16</td> </tr> <tr> <td>2. Prokurime me vlere minimale</td> <td>102</td> </tr> <tr> <td>3. Prokurime me vlere te vogël</td> <td>46</td> </tr> <tr> <td>4. Prokurime me vlere te mesme</td> <td>12</td> </tr> <tr> <td>5. Prokurime me vlere te madhe</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>6. Prokurime një burimore</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td style="text-align: right;">Totali i prokurimeve</td> <td>191</td> </tr> </table>	1. Te anuluarat për arsye objektive dhe ne mungese te ofertave	16	2. Prokurime me vlere minimale	102	3. Prokurime me vlere te vogël	46	4. Prokurime me vlere te mesme	12	5. Prokurime me vlere te madhe	1	6. Prokurime një burimore	14	Totali i prokurimeve	191	<p>Komentet e juaja për sa i përket numrit të procedurave të prokurimit janë të pranueshme dhe ne pas rishikimit te bere si te tilla i kemi inkorporuar në raportin final.</p>
1. Te anuluarat për arsye objektive dhe ne mungese te ofertave	16															
2. Prokurime me vlere minimale	102															
3. Prokurime me vlere te vogël	46															
4. Prokurime me vlere te mesme	12															
5. Prokurime me vlere te madhe	1															
6. Prokurime një burimore	14															
Totali i prokurimeve	191															
	<p><i>Pika 3.4 pasusi "Shpenzimet e reprezentacionit"</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Te gjitha faturat e reprezentacionit kane qene qarte te shkruara artikujt (pijet dhe ushqimin) e shërbyer, qofte ne fature gjeneralë, apo te bashkangjitur kane kuponin e arkës apo paragonin e qe korrespondojnë me vlerën e faturuar. <p>Ndërsa kontratat qe i nënshkruan shefi i kabinetit pajtohem për shkak te sqarimeve te dokumentuara nga zyra e prokurimit.</p>	<p>Ligji mbi Prokurimin Publik është i çartë sa i përket autorizimeve te nënshkrimit te kontratave. E gjetura dhe rekomandimi mbeten te njëjta.</p>														
	<p><i>Pika 3.4 " Mungojne Fletepranimet e mallrave"</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ne baze te dokumenteve qe ju i posedoni tregon qarte se te gjitha mallrat e blera nga ZKM pranohen me procesverbal nga tre anëtar. 	<p>Auditori pajtohet me komentin e ZKM-së dhe dëshmitë se malli është pranuar me procesverbal nga tre anëtar.</p> <p>Por e gjetura ka te beje me atë se malli i pranuar nuk është regjistruar në regjistrin e pranimet e as në regjistrin e pasurisë.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi i auditorit mbesin.</p>														
3.8	<p>3.7 Menaxhimi i Pasurisë</p>															

	<p>Pajtohem me rekomandimin e dhëna lidhur me regjistrin e pasurisë. Qe nga gjysme-vjetori i dytë i vitit 2008 ne ZKM aplikohet programi ne forme elektronike për menaxhimin e pasurive. Sistemi apo programi ishte ne fazën testuese, dhe se, ky program iu ka përshtatur kërkesave te Instruksionit Administrativ nr. 2005/11.</p>	<p>ZKM pajtohet me rekomandimin dhënë dhe ne inkurajojm qe ZKM ta beje funksionale sistemin për menaxhimin e pasurisë Rekomandimi mbetet i njëjtë</p>
4	<p>4. Sistemi i Kontrollit te brendshëm</p> <p>Komenti:</p> <p>Kontrolla e brendshme funksionon, Respektimi i dispozitave ligjore, udhëzimeve administrative dhe vendimeve te ndryshme edhe për kundër lëshimeve simbolike, paraqesin dëshminë e ekzistimit te kontrollës se brendshme.</p>	<p>ZKM duhet te nxjerr politika te brendshme për përmirësimin e sistemit te kontrollit te brendshëm. Ne funksion te saj është edhe rekomandimi i dhënë.</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë</p>
5	<p>5. Auditimi i Brendshëm</p> <p>Komenti i Njësisë për Auditim te Brendshëm:</p> <p>Opinion i dhënë nga ZAP-ja për Njësinë e Auditimit te Brendshëm është konstatim i drejt dhe do ta zbatojmë rekomandimin e dhëne.</p>	<p>ZKM zotohet për implementimin e rekomandimit, ne do ta vlerësojmë nivelin e zbatimit gjate auditimeve te ardhshme.</p> <p>Rekomandimi mbetet i njëjtë</p>

